



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E EKONOMISË, KULTURËS DHE INOVACIONIT
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E METROLOGJISË
DREJTORIA E METROLOGJISË LIGJORE

Nr. 259 Prot.

Tiranë më 07.02.2025

Lënda: Kthim Përgjigje

Në përgjigje të shkresës Tuaj me Nr. AH/1 prot, datë 19.01.2025 "Kërkohet informacion dhe kopje me vulë nga ana juaj të dokumentacionit të kolaudimit (kontrollit teknik) të të gjitha aparatëve matës të shpejtësisë së mjeteve rrugore të kolauduara nga ana e në Shqipëri, duke përcaktuar datën e hyrjes në laborator dhe datën e daljes nga laborator, veprimet e kryera të kolaudimit, aktin e kolaudimit, gjithë kohën e kolaudimit, datën dhe vendin e kolaudimit të aparatëve si dhe dokumente të tjera bashkëngjitur" protokolluar në DPM me nr.259 prot, datë 24.01.2025 Drejtoria e Përgjithshme e Metrologjisë(DPM), Ju bën me dije se:

Referuar ligjit nr.126/2020 "Për Metrologjinë", VKM me nr. 463, datë 18.07.2012 "Për një shtesë në vendimin nr. 1351, datë 03.10.2008 të KM "Për miratimin e rregullores për kërkesat teknike metrologjike të instrumenteve matëse ligjërisht të kontrolluara", radarët e matjes së shpejtësisë janë instrumenta matës ligjërisht të kontrolluara dhe si rrjedhojë duhet ti nënshtrohen kontrollit të detyruar ligjor.

DPM për këto instrumenta matës ligjërisht të kontrolluara nuk kryen shërbim, pasi nuk disponon kapacitetet dhe infrastrukturën e duhur teknike.

Për sa më lart, pronari i instrumentëve matës ligjërisht të kontrolluara (aparat matës të shpejtësisë së mjeteve rrugore) është Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit dhe lidhur me kërkesën tuaj duhet ti drejtoheni këtij të fundit.

Duke Ju falenderuar,

DREJTORI I PËRGJITHSHËM

(I Komanduar)

Erinda Piluri

